



▶ DIALOGU, TOLERANCA
DHE MIRËKUPTIMI
PËRMES ARTIT DHE
KULTURËS.....1



▶ BREZAT E RI QË
PREMTOJNË
SHUMË.....1



▶ ZGJIDHJE AFATGJATE
PËR FURNIZIM ME
UJË TË PIJSHËM2



▶ VIZAT-KRIJIMI I
PERSPEKTIVËS
EVROPIANE
PËR KOSOVARËT...2



Republika e Kosovës – Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Zyra e Kryeministrit – Kancelarija premijera –Office of the Prime Minister
Zyra për Çështje të Komuniteteve / Kancelarija za pitanje zajednica / Office for Community Affairs

Fuqia në diversitet

DIALOGU, TOLERANCA DHE MIRËKUPTIMI PËRMES ARTIT DHE KULTURËS



12 artistë të grafikës paraqitën punimet e tyre para qytetarëve të Graçanicës në Ekspozitën e Grafikës të cilën e ka përkrahur Zyra për Çështje të Komuniteteve

Ky projekt i miratuar për financim nga Qeveria e Kosovës, është në dobi të zhvillimit të aktiviteteve kulturore të artistëve vendas dhe ka për qëllim promovimin e artit, kulturës dhe traditës serbe në përgjithësi.

Në këtë ekspozitë morën pjesë 12 artistë të talentuar me punimet e tyre grafike. Në ceremoninë e hapjes pati vizitorë të shumtë të cilët kishin ardhur për të ndjekur manifestimin dhe për të parë nga afër rreth 30 punime artistike të ekspozuara nga artistët serbë. Talentët e rinj kishin ndërtuar kompozicione pikturale të ndryshme dhe dinamike të trajtave, të vijave dhe të ngjyrave, duke krijuar kështu vepra të shkëlqyera të artit grafik.

Drejtori i Zyrës për Çështje të Komuniteteve, z. Srdjan Sentic, në fjalimin e tij të mbajtur në ceremoninë e hapjes së kësaj ekspozite tha se

ndër prioritetet e zyrës që ai drejton, është edhe promovimi i kulturës si një segment shumë i rëndësishëm në zhvillimin shoqëror dhe afirmimin e identitetit kulturor.

“Përkrah rinisë dhe sportit, arti dhe kultura janë lëmi të rëndësishme të cilat nuk prekin kontekstin politik, derisa në anën tjetër japin mundësi të qenit së bashku dhe të shoqërizimit të njerëzve, të cilët japin një kontribut shumë të rëndësishëm për dialog duke krijuar një ardhmëri më të mirë për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë”, theksoi z. Sentic gjatë fjalimit të tij.

Përndryshe, ky nuk do jetë aktiviteti i vetëm kulturor i financuar nga ZÇK. Aktivitete të këtilla do të përkrahen edhe në të ardhmen, në mënyrë që në të ardhmen të mblidhen sa më shumë artistë nga të gjitha komunitetet.

BREZAT E RI QË PREMTOJNË SHUMË

Investimi në brezat e ri që premtojnë një ardhmëri më të ndritur për Kosovën është prioritet në veçanti i Zyrës për Çështje të Komuniteteve

Me qëllim që të krijohen elitat e së nesërme që do të kontribuojnë në institucionet e vendit, Zyra për Çështje të Komuniteteve ofron bursa studimi për nxënësit e dalluar nga radhët e komuniteteve jo-shumicë.

Në vitin 2009, ZÇK nënshkroi Memorandumin e bashkëpunimit me Universitetin Amerikan në Kosovë, për dhënie të bursave për studentë të dalluar. Në bazë të këtij Memorandumi, studentët e përzgjedhur përfitojnë bursa të plota studimi në lëmi të ndryshme që ofrohen nga këtë universitet. Bursat ndahen për një periudhë katër vjeçare dhe përfshijnë të gjitha shpenzimet.

Përfituesit paraprakisht duhet t'i plotësojnë një varg kriteresh, përfshirë këtu edhe rezultatit e fundvitit shkollor. Po ashtu, përfituesit obligohen që pas diplomimit të japin kontributin e tyre duke u punësuar në institucionet publike të Kosovës.

Adresa: Ndërtesa e Qeverisë, rruga: Nëna Terezë p. n.

Tel: +381 /0/ 38 200 14 444;

E-mail: zck-kpz@ks-gov.net

www.kryeministri-ks.net/zck/



ZGJIDHJE AFATGJATE PËR FURNIZIM ME UJË TË PIJSHËM PËR VENDBANIMET RURALE

ZÇK financon ndërtimin e dy rezervuarëve të ujit në fshatrat Kopernicë, Kolloleq, Shipashnicë, Budrigë dhe Zhegër

Ndërkaq, ujësjellësi për fshatrat Budrigë dhe Zhegër, është projekt i infrastrukturës i bashkë-financuar nga ZÇK dhe partnerë tjerë siç janë: Ministria për Komunitete dhe Kthim, Qeveria zvicerane dhe Kuvendi Komunal i Gjilanit.

Punimet për realizimin e këtyre dy projekteve kapitale janë duke vazhduar me dinamikë të lartë dhe afro 80% e punimeve të rrjeteve kanë arritur në fazën përfundimtare. Deri në fund të muajit tetor pritet të bëhet inaugurimi i tyre dhe banorët e këtyre zonave do të kenë kushte më të mira për jetesë.



Qytetarët që jetojnë në disa zona rurale, ku zhvillimi infrastrukturor dhe ekonomik është i mangët krahas vendbanimeve urbane, ballafaqohen me vështirësi në furnizimin me ujë të pijshëm. Banorët e fshatrave Kopernicë, Kolloleq, Budrigë dhe Zhegër për një kohë të gjatë ishin furnizuar me ujë të pijshëm përmes puseve individuale të tyre.

Me qëllim të evokimit të këtij problemi dhe përmirësimit të kushteve për furnizim me ujë, ZÇK financoi dy projekte për ndërtimin e rezervuarëve të ujit në këto vendbanime shumetnike.

Sistemi i përbashkët i ujësjellësit që përfshin linjën e fshatrave Kopernicë, Kolloleq dhe Shipashnicë, është projekt i infrastrukturës i bashkë-financuar nga Zyra për Çështje të Komuniteteve, Qeveria zvicerane dhe Kuvendi Komunal i Kamenicës. Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit trepalësh, ZÇK ka ndarë 71,250 euro për realizimin e këtij projekti.

VIZAT – KRIJIMI I PERSPEKTIVËS EVROPIANE PËR KOSOVARËT



Zyra për Çështje të Komuniteteve merr pjesë në Grupin Punues për Liberalizimin e Vizave

Një ndër prioritetet kryesore të Qeverisë së Republikës së Kosovës është edhe procesi i liberalizimit të vizave, në mënyrë që qytetarëve të Kosovës t'u krijohet një perspektivë evropiane, përmes mundësisë së udhëtimit pa viza në vendet e zonës Schengen të Bashkimit Evropian.

Autoritet shtetërore janë duke punuar intensivisht për plotësimin e kushteve të kërkuara. Në dhjetor të vitit 2009, me vendim të ministrit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, u krijua Grupi Punues për koordinimin, monitorimin dhe raportimin e të gjitha aktiviteteve të Qeverisë së Kosovës për implementimin e Planit të Veprimit për procesin e liberalizimit të vizave. Ky Grup Punues është grup multi-disciplinar me përfaqësues nga ministritë dhe agjencitë e ndryshme, si dhe përfaqësues të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian. Pjesa më e madhe e parakushteve të cilat synojnë arritjen e kushtit për fillimin e procesit të liberalizimit të vizave i takon Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila është edhe koordinatore e këtij grupi.

Zyra për Çështje të Komuniteteve merr pjesë në këtë grup punues duke raportuar për rrjedhën e disa proceseve që ndërlidhen drejtpërsëdrejti për të drejtat e komuniteteve.

PROJEKTE QË DËSHMOJNË PËRKUSHTIMIN E QEVERISË SË KOSOVËS

Dy projekte për të cilat këto dy ditë u bë pranim-dorëzimi, dëshmojnë edhe njëherë përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për të ndihmuar komunitat e reja në promovimin e sportit dhe rekreacionit

Tash e tutje të rinjtë e Graçanicës do të kenë mundësi rekreacioni në fushat e reja të tenisit të cilat janë ndërtuar në një sipërfaqe prej 1596 m². Ky projekt u financua nga ZÇK dhe partnerët, në mënyrë që të rinjtë të kësaj zone t'u ofrohen mundësi për zhvillimin e aktiviteteve sportive. Fushat e tenisit kanë sipërfaqe prej 260 m² dhe posedojnë ulëse për 138 vizitorë. Derisa rruga që lidh Graçanicën dhe Llapnasellën së bashku me ndiçmin, projekt ky i cili ka përfunduar këto ditë, paraqet një hap më shumë drejt zhvillimit të infrastrukturës dhe ofron siguri dhe mundësi



më të mira për udhëtarët. Ky investim përfshin rrugën në gjatësi prej afro 3,500 m dhe është projekt i financuar nga ZÇK dhe partnerët. Këto dite pritet edhe konfirmimi i KEK-ut që të lidhet në sistemin energjetik dhe menjëherë ky ndriçim të lëshohet në punë.

